



**UNIVERSITETI I TETOVËS**  
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО - UNIVERSITY OF TETOVA

Bul. "Ilinden" p.n. 1200 Tetovë | Tel: +389 44 356 500 | Fax: +389 44 356 222  
e-mail: international@unite.edu.mk | www.unite.edu.mk

## NJOFTIM

Njoftohen të interesuarit se **Buletini nr. 137** i Universitetit të Tetovës është publik dhe i njëjti mund të shikohet nga të interesuarit te Dekanët e fakulteteve të Universitetit të Tetovës.

Buletini do të jetë publik duke filluar nga 27.11.2018 deri më 11.12.2018.

Tetovë, 27.11.2018



Deri te:

## **KËSHILLI I REKTORATIT TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS**

Në bazë të nenit 102 dhe 173 të Ligjit për Arsimin e Lartë (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 82/2018) dhe nenit 144 të Statutit të Universitetit të Tetovës dhe në pajtim me Rregulloren për kritere të veçanta dhe procedurën për zgjedhje-rizgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, mësimore-profesionale dhe thirrjen e bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, si dhe në bazë të Propozimit të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës nr. **16-1366/1** të datës 20.11.2018 dhe në bazë të Vendimit të Këshillit të Rektoratit nr. **02-5081/1** të datës 21.11.2018 lidhur me konkursin e shpallur në gazetat “Koha” dhe “Nova Makedonia” të datës 10.11.2018 si dhe në web faqen e Universitetit, [www.unite.edu.mk](http://www.unite.edu.mk), për zgjedhjen-rizgjedhjen e një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore për lëndët: Arabishtja bashkëkohore I dhe II, Përkthimi i teksteve klasike arabe dhe Përkthimi i teksteve bashkëkohore arabe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Tetovës, komisioni në përbërje:

- 1. Prof. dr. Ismail Ahmedi, kryetar, profesor ordinar në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Tetovës;**
- 2. Prof. dr. Abdulla Hamiti anëtar, profesor i rregullt në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës;**
- 3. Prof.dr. Adnan Ismaili, anëtar, profesor indordinar në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Tetovës.**

pasi shqyrtoi dokumentacionin e arritur në të cilin kishte marrë pjesë vetëm një kandidat, edhe atë Dr.s. Ataullah Aliji ka nderin t’Ju paraqesë këtë:

## REFERAT

### 1. Të dhënat biografike, përgatitja profesionale-shkencore dhe aktiviteti pedagogjik

Dr.sc. Ataullah Aliji, u lind më 28.05.1957, në fshati Nikushtak, komuna e Likovës, ku dhe e kreu shkollën fillore. Shkollën e mesme e kreu në Medresenë Alaudin në Prishtinë. Studimet deridiplomike i kreu në Fakultetin Filologjik, Universiteti i Prishtinës, dega e Orientalistikës. Gjithashtu i përfundoi edhe studimet në Fakultetin e Shkencave Islame në Prishtinë. Studimet e magjistraturës i përfundoi me sukses në Universitetin Ndërkombëtar të Novi Pazarit, në vitin 2009, ku mbrojti temën e magjistraturës “*Nocioni fitne dhe ibtila në përkthimin e Sherif Ahmetit*”. Studimet e doktoraturës i vazhdoi po në Universitetin Ndërkombëtar të Novi Pazarit, dhe i përfundoi në vitin 2013, duke mbrojtur temën “*Nocioni fitne dhe interpretimi i mufesirëve*”.

Gjatë veprimtarisë së tij profesionale dhe shoqërore Ataullah Aliji deri më tash ka kryer më shumë detyra dhe funksione, sikur që janë: sekretar gjeneral i Shoqatës “Ilmije” të Bashkësisë Fetare Islame gjatë periudhës së viteve 1998-2005, redaktor në Shtëpinë botuese Logos-A, që nga viti 2005, ku redaktoi dhjetëra botime dhe përkthime në gjuhën shqipe. Shkruan dhe flet disa gjuhë. Në veprimtarinë e begatshme shkencore vërehet pjesmarrje në shumë seminare, konferencave shkencore dhe simpoziume të ndryshme brënda dhe jashtë vendit.

Nga shtatori i vitit 2012 është i angazhuar si ligjërues part-time në Universitetin e Tetovës, Fakulteti Filozofik, Filologji orientale, dhe gjithashtu është zgjedhur në thirrje mësimore shkencore titullare Docent, nga Universiteti Ndërkombëtar i Novi Pazarit.

### 2. Veprimtaria shkencore

Nga biografia e paraqitur mund të shihet se Dr. Sc. Ataulla Aliji pas përfundimit të studimeve të magjistraturës dhe të doktoraturës ka zhvilluar në veprimtari serioze shkencore, e cila në vete ngërthen disa vepra autoriale nga fusha e studimeve orientale, sikur janë

1. Ataullah Aliu, *Kur'ani për disa dukuri negative të njeriut*, Logos- A, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2006.

2. Mr. hfz. Ataullah Aliu, *Muslimani në kohë dhe marginalizmi eventual i sistemit hyjnor*, Logos- A, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2011.
  3. Mr. hfz. Ataullah Aliu, *Ibn Abbasi mufessiri i tretë*, Logos- A, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2011.
  4. Mr. hfz. Ataullah Aliu, *Koncepti i Kur'anit për da'ven*, Logos – A, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2011,
  5. Hfz. doc. dr. Ataullah Aliu, *Kur'anski koncept pojma fitne i tumaçenja mufessira*, El-Kelimeh, Novi Pazar, 2018.
  6. Hfz. doc. dr. Ataullah Aliu, *Koncepti i Kur'anit për nocionin fitne dhe interpretimet e mufessirëve* (disertacion doktore, në dorëshkrim), Novi Pazar, 2013
- Njohja gjuhës arabe dhe gjuhëve tjera orientale i mundësuan që të thellohet në studime edhe të natyrave krahasuese gjuhësore. Poashtu pjesë e interesimit të tij shkencor janë edhe problematika të caktuara religjioze si dhe kontributi personaliteteve të rëndësishme në fushëm e studimeve orientale, gjë që pasqyrohet në një numër të madh shkrimesh të botuara në revista të ndryshme, sikur janë:
1. Ataullah Aliu, *Nyja shqiptare dhe ndihma e Allahut xh.sh.*, HËNA E RE, nr. 54, Shkup, 1993.
  2. Ataullah Aliu, *Haxhi shtyllë e pestë e islamit*, HËNA E RE, nr., 119., MBI., Shkup, 1996.
  3. Ataullah Aliu, *Besimi në mizan – peshojë*, HËNA E RE, nr., 131., MIB., Shkup, 1998.
  4. Ataullah Aliu, *Të urdhëruarit në të mirë dhe të ndaluarit nga e keqja*, HËNA E RE, nr., 132., MIB., Shkup, 1998.
  5. Ataullah Aliu, *Relevanca multidimensionale e kurbanit*, HËNA E RE, nr., 138., Shkup 1998.
  6. Ataullah Aliu, *Shkëlqimet e vitit të ri hixhri 1419*, HËNA E RE, nr., 138., Shkup, 1998.
  7. Ataullah Aliu, *Fati i Ebrehas*, HËNA E RE, nr., 140, BIM., Shkup, 1998.
  8. Ataullah Aliu, *Është absurd dominimi i së keqes në jetën islame*, LOBI, nr, 145, Shkup, 2003.
  9. Ataullah Aliu, *Pse disa probleme nuk evitohen*, FAKTI, 14 tetor, Shkup, 2005.
  10. Ataullah Aliu, *Për zgjidhjen e çështjeve duhet drejtuar sistemit hyjnor*, FAKTI, 15 tetor, Shkup, 2005.
  11. Ataullah Aliu, *Zbehja e shprehjeve „interes islam“ dhe „për islam“*, FAKTI, 17 tetor, Shkup, 2005.
  12. Ataullah Aliu, *Dhuratë, rruga e drejtë*, FAKTI, 18 tetor, Shkup, 2005.
  13. Ataullah Aliu, *Besimtari i mirë nuk tronditet*, FAKTI, 19 tetor, Shkup, 2005.
  14. Ataullah Aliu, *Një ditë e veçantë (festa e Bajramit)*, FAKTI, 2 nëntorë, Shkup, 2005.

15. Ataullah Aliu dhe Adnan Ismaili, *Hfz. ef. Idriz Idrizi*, DITURIA ISLAME, nr., 188., Prishtinë, 2006.
16. Ataullah Aliu, *Egzegjeza e Kur'nit për padrejtsinë*, UNIVERSI, nr. 7, AIITC, Tiranë, 2007.
17. Mr. hfz. Ataullah Aliu, *Egzegjez e Kur'ani Kerimit mbi retorikën*, EDUKATA ISLAME, nr., 92., BIK., Prishtinë, 2010.
18. Mr.hfz. Ataullah Aliu, *Egzegjeza e Kur'ani Kerimit për kurvërinë*, DRITA E JETËS, nr., 7-8., Gilan, 2010.
19. Mr.hfz. Ataullah Aliu, *Musliman u vremenu i eventualna marginalizacija Božanskog sistema*, NOVI MUALIM, br. 41., Sarajevo, 2010.
20. Doc. dr. hfz. Ataullah Aliu, *Relevanca gjuhësore e nocionit fitne në Kur'an*, PHILOSOPHICA, NR., 8., UNIVERSITETI I TETOVËS, Tetovë, 2017.
21. Doc. dr. hfz. Ataullah Aliu, *Nocioni kur'anor el-ibtilā' dhe përkthimi i Sherif ef. Ahmetit*, HËNA E RE., nr., 319-320., BIM., Shkup, 2018.

Dr.sc. Ataullah Aliji, duke qenë njohës i mirë i gjuhës arabe, spikat edhe në mjeshtërinë e përkthimit nga kjo gjuhë, me çka na na dëshmon se përveç që e ka të përvetësuar në nivelet më të lartë shkencore, ai është edhe praktikues i saj. Veprimtaria përkthyesë e tij është shumë e begatshme dhe e një rëndësie të veçantë për studimet orientale në gjuhë shqipe.

Nga veprat e përkthyerë prej gjuhës arabe do të veçojmë:

1. Sejfetin Jazëxhë, *El-Islam tarik'us-seadeti*, (përktheu nga arabishtja: Ataullah Aliu) Logos-A, Shkup, 1423/2002.
2. *Hadithe Kudsij* (përzgjedhi dhe përktheu nga arabishtja: Ataullah Aliu), Logos-A, Shkup, 1423/2002.
3. Ebu El-Hasen En-Nedevi, *Kissas'un-nebijine li'l-etfāli (Rrëfime mbi peygamberët për fëmijë)*, / përktheu nga arabishtja: Ataullah Aliu /, Logos- A, Shkup, 2006.
4. ELVA'J'UL-ISLAMI (organ botues-informativ), *Risalet'us-sijami/* botim i veçantë i ELVA'JUL-ISLAMI-T/, (*Mbi agjërimin*), /përktheu nga arabishtja: Ataullah Aliu/, O.H. Merhamet, Shkup, 2009.
5. Halil Ibrahim Kutllaj, *Katërzet hadithe, I-II*, (përktheu nga arabishtja: Ataullah Aliu), Logos-A, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2009.

6. Abdullah Halife, *Hajru Ramadani-Kejfe tehsil alejhi (Mirësia e Ramazanit – Si ta arrish atë)*, Logos-A, (përktheu nga arabishtja: Mr. hfz. Ataullah Aliu), Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2010.
7. Muhamed El-Gazali, *Ejjuhel-Veled (O djalosh)*, në kuadër të teksteve të kompiluara – *Ty rini*, (përktheu nga arabishtja: Mr. hfz. Ataullah Aliu), /qëndroi në dorëshkrim që nga viti 1986 /, Logos- A, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2011.
  - Ebu-El-Hasen En-Nevedi, *Kisas 'un-nebijiine li 'l-etfāli (Rrëfime mbi pejgamberët për fëmijë)*, /përktheu nga arabishtja: Mr. hfz. Ataullah Aliu /, Logos- A, botimi i dytë, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2011.
  - Muhamed El-Gazali, *Ejjuhel-Veled (O djalosh)*, / e përktheu nga arabishtja: Dr. hfz. Ataullah Aliu /, Logos- A, botimi i dytë, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2015.
8. DËYANET İŞLERİ BAŞKANLIĞI YAYINLARI, *Katërdhjetë hadithe për dinjitetin e njeriut*, (përktheu nga arabishtja: Doc. dr. hfz. Ataullah Aliu), O.H. Merhamet, Shkup, 2016.
9. DËBY., *Katërdhjetë hadithe mbi ndihmën dhe solidaritetin*, (përktheu nga arabishtja: Doc. dr. hfz. Ataullah Aliu), O.H. Merhamet, Shkup, 2016.
10. DËBY., *Katërdhjetë hadithe mbi familjen*, (përktheu nga arabishtja: Doc. dr. hfz. Ataullah Aliu), O.H. Merhamet, Shkup, 2016.
11. DËBY., *Katërdhjetë hadithe për fqinjësinë, farefisën dhe shokun për hirë të Allahut xh.sh.*, (përktheu nga arabishtja: Doc. dr. hfz. Ataullah Aliu), O.H. Merhamet, Shkup, 2016.
12. DËBY., *Katërdhjetë hadithe për fëmijën*, (përktheu nga arabishtja: Doc. dr. hfz. Ataullah Aliu), O.H. Merhamet, Shkup, 2016.
13. DËBY., *Katërdhjetë hadithe për mëshirën*, (përktheu nga arabishtja: Doc. dr. hfz. Ataullah Aliu), O.H. Merhamet, Shkup, 2016.
14. DËBY., *Katërdhjetë hadithe për agjërimin*, (përktheu nga arabishtja: Doc. dr. hfz. Ataullah Aliu), O.H. Merhamet, Shkup, 2016.
15. DËBY., *Katërdhjetë hadithe për namazin me xhemat, për imamllëkun dhe për muezinllëkun*, (përktheu nga arabishtja: Doc. dr. hfz. Ataullah Aliu), O.H. Merhamet, Shkup, 2016.
16. DËBY., *Katërdhjetë hadithe –lutjet që i bëri Muhamedi a.s.*, (përktheu nga arabishtja: Doc. dr. hfz. Ataullah Aliu), O.H. Merhamet, Shkup, 2016.

17. Jusuf bin Sejjid Hashim Err- Rrifai, *Nasihatur li-ihvetinā ulemai nexhd (Këshillë për vëllezërit tanë Ulemanë e Nexhdit)*/ përktheu nga arabishtja: Doc. dr. hfz. Ataullah Aliu /, - në dorëshkrim.

Përveç veprave në fjalë, gjithashtu na paraqitet edhe si përkthyes i disa teksteve po nga gjuha arabe, prej të cilave do ti veçojmë:

1. *Llojet dhe disa nga rregullat e agjërimit*, (përktheu nga arabishtja: Ataullah Aliu), KOHA DITORE, 13 tetor, Shkup, 2005.
2. *Ditunia ka mbështetje në Kur'anin Fisnik dhe në sunnetin e Pejgamberit a.s.*, (përktheu nga arabishtja: Ataullah Aliu), DITURIA ISLAME, nr., 224., BIK., Prishtinë, 2009.
3. *Tevekkuli (mbështetja) në Zotin xh.sh.*, (përktheu nga arabishtja: Ataullah Aliu), DITURIA ISLAME, nr., 226., BIK., Prishtinë, 2009.

Përveç, gjuhës arabe dhe gjuhëve tjera orientale, Dr.sc. Ataullah Aliji na paraqitet edhe si njohës i mirë gjuhëve ballkanike, e në veçanti i gjuhës boshnjake, prej të cilës gjithashtu ka përkthyer një numër të madh të veprave:

1. Dr. Ahmet Smajloviq, *Kako češ biti musliman (Si të bëhesh musliman)*, / përktheu nga boshnjakishtja: Ataullah Aliu /, Botues: Adnan Ismaili (botim privat), Shkup, 1411/1990; 1412/1992, Tetovë (brenda një viti përjetoi tre botime); 1413/1992 1994 dhe 1999 (sipas informacioneve, deri më tani ka përjetuar tetë botime).
2. Mehmed Handžić, *Uvod u tefsirsku nauku (Hyrje në shkencën e tefsirit)* / përktheu nga boshnjakishtja: Ataullah Aliu / – në dorëshkrim, që nga viti 1988.

Përveç veprave në fjalë, gjithashtu ka përkthyer edhe tekste të tjera të rëndësishme për studimet orientale edhe ato islame, sikur janë:

4. Lejla el- Zuher, *Si t'u flitni mbi Zotin fëmijëve të moshës dhjetë vjeçarë*, (përktheu nga boshnjakishtja: Ataullah Aliu), DITURIA ISLAME, nr., 3., KBI., Prishtinë, 1986.
5. Mehmed Hanxhiq, *Hyrje në shkencën e tefsirit*, (përktheu nga boshnjakishtja: Ataullah Aliu), HËNA E RE, nr., 62, MBI., Shkup, 1993.
6. M. H., *Hyrje në shkencën e tefsirit*, (përktheu nga boshnjakishtja: Ataullah Aliu), HËNA E RE, nr., 63, MBI., Shkup, 1993.
7. M.H., *Hyrje në shkencat e tefsirit*, (përktheu nga boshnjakishtja: Ataullah Aliu), HËNA E RE, nr., 64, MBI., Shkup, 1993.

8. Hasan Sushiq, *Ngjashmëritë dhe dallimet e mendimeve filozofike*, (përktheu nga boshnjakishtja: Atallah Aliu), HËNA E RE, nr., 65, MBI., Shkup 1993.
9. *Ngjashmëritë dhe dallimet e mendimeve filozofike*, (përktheu nga boshnjakishtja: Atallah Aliu), HËNA E RE, nr., 66, MBI., Shkup, 1993.
10. *Mendime të Omer ibn el-Hattabit*, (përktheu nga boshnjakishtja: Atallah Aliu), TAKVIM, Shkup, 1995/1415-16
11. *Rendi i jetës në islam*, (përktheu nga boshnjakishtja: Atallah Aliu) HËNA E RE, nr., 120, MBI., Shkup, 1996.
12. *Qëllimi të cilin duhet synuar njeriu*, (përktheu nga boshnjakishtja: Atallah Aliu), HËNA E RE, nr., 121, MBI., Shkup, 1996.
13. *Rendi politik në islam*, (përktheu nga boshnjakishtja: Atallah Aliu), HËNA E RE, nr., 122, MBI, Shkup, 1996.
14. *Organizimi në shtetin islam*, (përktheu nga boshnjakishtja: Atallah Aliu), HËNA E RE, nr., 123, MBI., Shkup, 1996.
15. Ebul-Ala El-Mevdudi, *Tiparet e Um-metit Islam*, (përktheu nga boshnjakishtja: Atallah Aliu), HËNA E RE, nr., 124, MBI., Shkup, 1996.
16. Ebul-Ala el-Mevdudi, *Um-meti islam*, (përktheu nga boshnjakishtja: Atallah Aliu), HËNA E RE, nr., 126, MBI., Shkup, 1996.
17. *Namazi (falja- kryerja e pesë namazave ditore është pjesë e dytë përbërëse e bazamentit islam*, (përktheu nga boshnjakishtja: Atallah Aliu), TAKVIM, Shkup, 1998/ 1418-19.
18. *Ramazani, muaj i agjërimit*, (përktheu nga boshnjakishtja: Atallah Aliu), KOHA DITORE, 7 tetor, Shkup, 2005.



## **Mendim me propozim**

Në bazë të pasqyrës të prezantuar më lart si dhe nga të dhënat në **Shtojcë**, komisioni Recensues i vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtaritë mësimore-arsimore, shkencore-hulumtuese, profesionale-aplikative dhe ato me interes të gjerë dhe konstaton se kandidati **Dr.sc. Ataulla Aliji** në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës (Buletini i universitetit), ka tubuar pikë të mjaftueshme duke e kaluar numrin minimal të pikëve që duhet të realizohen për zgjedhjen në thirrjen mësimore-shkencore **Docent**.

Duke u mbështetur në vlerësimet pozitive të paraqitura në këtë referat, Komisioni recensues konsideron se kandidati **Dr.sc. Ataulla Aliji** i plotëson të gjitha kriteret shkencore e profesionale për t'u zgjedhur në thirrjen mësimore-shkencore **Docent** për lëndët **Arabishtja bashkëkohore I dhe II, Përkthimi i teksteve klasike arabe dhe Përkthimi i teksteve bashkëkohore arabe** në programin studimor Filologji orientale.

Rrjedhimisht, kemi kënaqësinë që me bindje të plotë t'i rekomandojmë Këshillit të Rektoratit të Universitetit Shtetëror të Tetovës që ta aprovojë mendimin e këtij referati e të veprojë në pajtim me normat ligjore.

**Tetovë, 26.11.2018**

**Komisioni recensues::**

**Prof.dr. Ismail Ahmedi ( Kryetar)**

**Prof.dr. Abdulla Hamiti (Anëtar)**

## SHTOJCË

### PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE, SHKENCORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE

**Kandidati:** Atallah Aliji

**Institucioni:** Fakulteti Filozofik – UT, Tetovë

**Lëmia shkencore:** Filologji orientale

#### VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Nr.	Emri i aktivitetit:	Pikët
<b>1.</b>	<b>Mbajtja e ligjëratave (lëndët në ciklin e pare të studimeve)</b>	<b>63.6 pikë</b>
1.1.	Arabshtja bashkëkohore I, Filologji orientale, 1+3	5x15x4x0.04=12
1.2.	Arabshtja bashkëkohore II, Filologji orientale, 1+3	5x15x4x0.04=12
1.3.	Arabshtja bashkëkohore III, Filologji orientale, 1+3	5x15x4x0.04=12
1.4.	Arabshtja bashkëkohore IV, Filologji orientale, 1+3	5x15x4x0.04=12
1.5.	Morfologji e gjuhës arabe II, Filologji orientale, 0+2	1x15x2x0.04=1.2
1.6.	Morfosintaksë e gjuhës arabe , Filologji orientale , 0+2	1x15x2x0.04=1.2
1.7.	Përkthimi i teksteve bashkëkohore arabe , Filologji orientale, 2+2	3x15x4x0.04=7.2
1.8.	Përkthimi i teksteve klasike arabe , Filologji orientale, 2+0	2x15x2x0.04=2.4
1.9.	Arabshtja bashkëkohore VII, Filologji orientale, 1+2	1x15x3x0.04=1.8
<b>2</b>	<b>Konsultime me studentë</b>	<b>1.16 pikë</b>
2.1.	Arabshtja bashkëkohore I, Filologji orientale, 1+3	20x5x0.002=0.2
2.2.	Arabshtja bashkëkohore II, Filologji orientale, 1+3	20x5x0.002=0.2
2.3.	Arabshtja bashkëkohore III, Filologji orientale, 1+3	20x5x0.002=0.2
2.4.	Arabshtja bashkëkohore IV, Filologji orientale, 1+3	20x5x0.002=0.2
2.5.	Morfologji e gjuhës arabe II, Filologji orientale, 0+2	20x1x0.002=0.04
2.6.	Morfosintaksë e gjuhës arabe , Filologji orientale , 0+2	20x1x0.002=0.04
2.7.	Përkthimi i teksteve bashkëkohore arabe , Filologji orientale, 2+2	20x4x0.002=0.16
2.8.	Përkthimi i teksteve klasike arabe , Filologji orientale, 2+0	20x2x0.002=0.08
2.9.	Arabshtja bashkëkohore VII, Filologji orientale, 1+2	20x1x0.002=0.04

<b>3.</b>	<b>Mentor i punimeve të diplomës</b>	<b>0.4 pikë</b>
3.1	Mentor i punimit të diplomës, vendimi nr. 16-743/2, data : 2018	0.2
3.2	Mentor i punimit të diplomës, vendimi nr. 02-6287/1, data: 08.11.2013	0.2
<b>4.</b>	<b>Anëtar i komisionit për vlerësimin ose mbrojtjen e punimeve të diplomës</b>	<b>3.2 pikë</b>
4.1	Komisioni për mbrojtjen e temës së diplomës-Kryetar, vendimi nr. 16-294/3, data: 2018	0.2
4.2	Komisioni për mbrojtjen e temës së diplomës-Kryetar, vendimi nr. 16-597/2, data:2018	0.2
4.3	Komisioni për mbrojtjen e temës së diplomës-Kryetar, vendimi nr.16-1079/3, data:25.12.2017	0.2
4.4	Komisioni për mbrojtjen e temës së diplomës-Kryetar, vendimi nr. 16-1694/1, data:30.09.2016	0.2
4.5	Komisioni për mbrojtjen e temës së diplomës-Kryetar, vendimi nr. 16-1095/3, data:03.05.2018	0.2
4.6	Komisioni për mbrojtjen e temës së diplomës-Kryetar, vendimi nr. 16-1863/1, data:13.10.2016	0.2
4.7	Komisioni për mbrojtjen e temës së diplomës-Kryetar, vendimi nr. 16-3090/2, data:29.12.2015	0.2
4.8	Komisioni për mbrojtjen e temës së diplomës-Anëtar, vendimi nr. 16-888/1, data:17.08.2018	0.2
4.9	Komisioni për mbrojtjen e temës së diplomës-Anëtar, vendimi nr.16-614/1, data:11.03.2016	0.2
4.10	Komisioni për mbrojtjen e temës së diplomës-Anëtar, vendimi nr. 16-1939/3, data:15.12.2015	0.2
4.11	Komisioni për mbrojtjen e temës së diplomës-Anëtar, vendimi nr. 16-981/3, data:02.10.2015	0.2
4.12	Komisioni për mbrojtjen e temës së diplomës-Anëtar, vendimi nr. 16-670/1, data 25.03.2015	0.2
4.13	Komisioni për mbrojtjen e temës së diplomës-Anëtar, vendimi nr.15-3198/1, data: 15.12.2015	0.2
4.14	Komisioni për mbrojtjen e temës së diplomës-Anëtar, vendimi nr. 02-768/1, data:25.12/2013	0.2
4.15	Komisioni për mbrojtjen e temës së diplomës-Anëtar, vendimi nr. 02-6285/1, data:08.11.2013	0.2
4.16	Komisioni për mbrojtjen e temës së diplomës-Anëtar, vendimi nr. 02-6290/1, data 08.11.2013	0.2
	<b>Gjithsej</b>	<b>68.36 pikë</b>

## VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Nr.	Emri i aktivitetit:	Pikët
<b>1.</b>	<b>Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revistë referente shkencore/profesionale me bord redaktues ndërkombëtar</b>	<b>30</b>
1.1	Ataullah Aliu dhe Adnan Ismaili, <i>Hfz. ef. Idriz Idrizi</i> , DITURIA ISLAME, nr., 188., Prishtinë, 2006.	6
1.2	Ataullah Aliu, <i>Egzegjeza e Kur'nit për padrejtsinë</i> , UNIVERSI, nr. 7, AIITC, Tiranë, 2007.	6
1.3	Mr. hfz. Ataullah Aliu, <i>Egzegjez e Kur'ani Kerimit mbi retorikën</i> , EDUKATA ISLAME, nr., 92., BIK., Prishtinë, 2010.	6
1.4	Mr.hfz. Ataullah Aliu, <i>Musliman u vremenu i eventualna marginalizacija Božanskog sistema</i> , NOVI MUALIM, br. 41., Sarajevo, 2010.	6
1.5	Doc. dr. hfz. Ataullah Aliu, <i>Revanca gjuhësore e nocionit fitne në Kur'an</i> , PHILOSOPHICA, NR., 8., UNIVERSITETI I TETOVËS, Tetovë, 2017.	6
<b>2</b>	<b>Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revistë referente shkencore/profesionale</b>	<b>26</b>
2.1	Doc. dr. hfz. Ataullah Aliu, <i>Nocioni kur'anor el-ibtilā' dhe përkthimi i Sherif ef. Ahmetit</i> , HËNA E RE., nr., 319-320., BIM., Shkup, 2018.	4
2.2	Mr.hfz. Ataullah Aliu, <i>Egzegjeza e Kur'ani Kerimit për kurvërinë</i> , DRITA E JETËS, nr., 7-8., Gilan, 2010.	4
2.3	Ataullah Aliu, <i>Nyja shqiptare dhe ndihma e Allahut xh.sh.</i> , HËNA E RE, nr. 54, Shkup, 1993.	4
2.4	Ataullah Aliu, <i>Haxhi shtyllë e pestë e islamit</i> , HËNA E RE, nr., 119., MBI., Shkup, 1996.	4
2.5	Ataullah Aliu, <i>Besimi në mizan – peshojë</i> , HËNA E RE, nr., 131., MIB., Shkup, 1998	4
2.6	Ataullah Aliu, <i>Të urdhëruarit në të mirë dhe të ndaluarit nga e keqja</i> , HËNA E RE, nr., 132., MIB., Shkup, 1998	4
2.7	Ataullah Aliu, <i>Revanca multidimensionale e kurbanit</i> , HËNA E RE, nr., 138., Shkup 1998.	4
2.8	Ataullah Aliu, <i>Shkëlqimet e vitit të ri hixhri 1419</i> , HËNA E RE, nr., 138., Shkup, 1998.	4

2.9	Ataullah Aliu, <i>Fati i Ebrehas</i> , HËNA E RE, nr., 140, BIM., Shkup, 1998.	4
3	<b>Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revista shkencore/profesionale të popullarizuara</b>	14
3.1	Ataullah Aliu, <i>Është absurd dominimi i së keqes në jetën islame</i> , LOBI, nr, 145, Shkup, 2003.	2
3.2	Ataullah Aliu, <i>Pse disa probleme nuk evitohen</i> , FAKTI, 14 tetor, Shkup, 2005.	2
3.3	Ataullah Aliu, <i>Për zgjidhjen e çështjeve duhet drejtuar sistemit hyjnor</i> , FAKTI, 15 tetor, Shkup, 2005.	2
3.4	Ataullah Aliu, <i>Zbehja e shprehjeve „interes islam“ dhe „për islam“</i> , FAKTI, 17 tetor, Shkup, 2005.	2
3.5	Ataullah Aliu, <i>Dhuratë, rruga e drejtë</i> , FAKTI, 18 tetor, Shkup, 2005.	2
3.6	Ataullah Aliu, <i>Besimtari i mirë nuk tronditet</i> , FAKTI, 19 tetor, Shkup, 2005.	2
3.7	Ataullah Aliu, <i>Një ditë e veçantë (festa e Bajramit)</i> , FAKTI, 2 nëntorë, Shkup, 2005.	2
2	<b>Pesëmarrje në takim shkencor/profesional me referat-prezentim oral</b>	2
2.1	Ataulla Alili Relevanca gjuhësore e nocionit fitne në KUR'AN, ARSIMI DHE EDUKIMI NË SHOQËRITË ME DIVERSITET KULTUROR, Fakulteti Filozofik - UT & Universiteti "Kadri Zeka"-Gjilan, 26.10.2016	2
3	<b>Abstrakt i botuar në librin e abstrakteve nga konferencat shkencore-Ndërkombëtare</b>	1
3.1	Ataulla Alili Relevanca gjuhësore e nocionit fitne në KUR'AN, ARSIMI DHE EDUKIMI NË SHOQËRITË ME DIVERSITET KULTUROR, Fakulteti Filozofik - UT & Universiteti "Kadri Zeka"-Gjilan, 26.10.2016	1
<b>Gjithsej</b>		<b>73 pikë</b>

## VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE

Nr. rendor	Emri i aktivitetit:	Pikët
<b>1</b>	<b>Libër nga lëmia profesionale</b>	<b>48</b>
1.1	Ataullah Aliu, <i>Kur'ani për disa dukuri negative të njeriut</i> , Logos- A, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2006.	8
1.2	Mr. hfz. Ataullah Aliu, <i>Muslimani në kohë dhe marginalizmi eventual i sistemit hyjnor</i> , Logos- A, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2011.	8
1.3	Mr. hfz. Ataullah Aliu, <i>Ibn Abbasi mufessiri i tretë</i> , Logos- A, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2011	8
1.4	Mr. hfz. Ataullah Aliu, <i>Koncepti i Kur'anit për da'ven</i> , Logos – A, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2011,	8
1.5	Hfz. doc. dr. Ataullah Aliu, <i>Kur'anski koncept pojma fitne i tumaçenja mufessira</i> , El-Kelimeh, Novi Pazar, 2018.	8
1.6	Hfz. doc. dr. Ataullah Aliu, <i>Koncepti i Kur'anit për nocionin fitne dhe interpretimet e mufessirëve</i> (disertacion doktore, në dorëshkrim), Novi Pazar, 2013	8
<b>2</b>	<b>Koordinator për përgatitjen e elaboratit të programit studimor</b>	<b>2</b>
2.1	Elaborat për organizimin e studimeve të ciklit të III – programi studimor Shkenca mbi gjuhën-Filologji orientale, 2017	2
<b>3</b>	<b>Pjesëmarrje në aktivitete promovuese të fakultetit</b>	<b>6</b>
3.1	Ditët e hapura, USHT, prezantim i programit studimor Filologji orientale, 2013	1
3.2	Ditët e hapura, USHT, prezantim i programit studimor Filologji orientale, 2014	1
3.3	Ditët e hapura, USHT, prezantim i programit studimor Filologji orientale, 2015	1
3.4	Ditët e hapura, UT, prezantim i programit studimor Filologji orientale, 2016	1
3.5	Ditët e hapura, UT, prezantim i programit studimor Filologji orientale, 2017	1
3.6	Ditët e hapura, UT, prezantim i programit studimor Filologji orientale, 2018	1
	<b>Gjithsej</b>	<b>56 pikë</b>

## VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJERË

<b>Nr. rendor</b>	<b>Emri i aktivitetit:</b>	<b>Pikët</b>
<b>1</b>	<b>Anëtar i komisionit të fakultetit</b>	<b>5</b>
1.1	Komisioni për vlerësimin e kompatibilitetit të Ciklit të -I- të studimeve, për regjistrim në ciklin e -II- Anëtar, vendimi nr. 15-7073/1, data: 20.11.2014	<b>1</b>
1.2	Për vlerësimin e kompatibilitetit të Ciklit të -I- të studimeve, për regjistrim në ciklin e -II- Anëtar, vendimi nr. 16-2250/1, data: 06.10.2015	<b>1</b>
1.3	Për vlerësimin e kompatibilitetit të Ciklit të -I- të studimeve, për regjistrim në ciklin e -II- Anëtar, vendimi nr. 16-2198/1, data: 03.11.2016	<b>1</b>
1.4	Për vlerësimin e kompatibilitetit të Ciklit të -I- të studimeve, për regjistrim në ciklin e -II- Anëtar, vendimi nr. 16-1468/1, data: 12.10.2017	<b>1</b>
1.5	Për vlerësimin e kompatibilitetit të Ciklit të -I- të studimeve, për regjistrim në ciklin e -II- Anëtar, 2018	<b>1</b>
<b>Gjithsej</b>		<b>5</b>

<b>REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN</b>	<b>Pikët</b>
<b>VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE</b>	<b>68.36</b>
<b>VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE</b>	<b>73</b>
<b>VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE</b>	<b>56</b>
<b>VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJERË</b>	<b>5</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>202.36</b>

Tetovë, 26.11.2018

Komisioni recensue:

Prof.dr. Ismail Ahmedi ( Kryetar)

**Prof.dr. Abdulla Hamiti (Anëtar)**

**Prof.dr. Adnan Ismaili (Anëtar)**



Deri te:

## **KËSHILLI I REKTORATIT TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS**

Në bazë të nenit 102 dhe 173 të Ligjit për Arsimin e Lartë (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 82/2018) dhe nenit 144 të Statutit të Universitetit të Tetovës dhe në pajtim me Rregulloren për kritere të veçanta dhe procedurën për zgjedhje-rizgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, mësimore-profesionale dhe thirrjen e bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, si dhe në bazë të Propozimit të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës nr. **16-1366/1** të datës **20.11.2018** dhe në bazë të Vendimit të Këshillit të Rektoratit nr. **02-5081/1** të datës **21.11.2018** lidhur me konkursin e shpallur në gazetata “Koha” dhe “Nova Makedonia” të datës 10.11.2018 si dhe në web faqen e Universitetit, [www.unite.edu.mk](http://www.unite.edu.mk), për zgjedhjen-rizgjedhjen e një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore për lëndët: **Gjuhë osmane I dhe II, Analiza e teksteve osmane dhe Historia e Perandorisë Osmane** në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Tetovës, komisioni në përbërje:

- 1. Prof. dr. Abdulla Hamiti, kryetar, profesor i rregullt në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës**
- 2. Prof. dr. Ismail Ahmedi anëtar, profesor i rregullt në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Tetovës**
- 3. Prof.dr. Dragi Georigiev, anëtar, profesor i rregullt në Institutin për Histori Nacione, Universiteti “ Kirili dhe Metodi” Shkup;**

pasi shqyrtoi dokumentacionin e arritur në të cilin kishte marrë pjesë vetëm një kandidat, edhe atë Doc. dr. Sulejman Baki ka nderin t’Ju paraqesë këtë:

## REFERAT

### 1. Të dhënat biografike, përgatitja profesionale-shkencore dhe aktiviteti pedagogjik

Sulejman Baki ka lindur më 01.10.1975 në Shkup. Arsimin fillore e kreu në shkollën fillore “Jane Sandanski” në Shkup, me mësim në gjuhën turke(1982-1990), ndërsa shkollimin e mesëm në gjimnazin “Imam Hatip Lisesi Medrese” në Bursa, R.e Turqisë (1990-1993).

Arsimin e lartë po ashtu e vazhdoi në Republikën e Turqisë, në Universitetin Uludag, Fakulteti Teologjik, ku dhe diplomoi në vitin 1998. Vitin e njëjtë Sulejman Baki i filloi studimet e magjistraturës në Institutin e Shkencave Sociale, të Universitetit Uludag, përkatësisht në degën e Shkencave Islame (Akad dhe Qelam). Në vitin 2001 me sukses e mbrojti punimin e magjistraturës me titull “Manastirli Ismail Haki dhe mendimet e tija në Kelam dhe librin e tij Tephisul-Kelam”, me çka e fitoi titullin shkencor magjistër.

Në vitin 2008 u regjistrua në studimet e doktoraturës në Institutin e Historisë Nacionale të universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, në grupin e Historisë Osmane. Në katër vitet e ardhshme nën mentorimin e Prof.d-r. Dragi Georgiev punoi në punimin e doktoraturës me titull “Formimi i klasës feudale në Gadishullin Ballkanik: Isa Beu nga Shkupi dhe familja e tij”, e cila me sukses u mbrojti më 29.03.2013, me çka Mr.sc. Sulejman Baki e fiton titullin doktor i shkencave historike.

Gjatë veprimtarisë së tij profesionale dhe shoqërore Sulejman Baki deri më tash ka kryer më shumë detyra dhe funksione, sikur që janë:

- 1993-1999 –programi për mësim-besim në RTVM-Redaksia në Gjuhën Turke
- nga 2002 –kryetar i shoqatës kulturore-arsimore dhe humanitare “ENSAR”
- 2003-2007 –nënkryetar i MATUSITEB( Lidhja e shoqatave joqeveritare turke në Maqedoni)
- 2007 – 2012 - kryetar i MATUSITEB
- nga 2004 – anëtar i redaksisë së revistës „ KÖPRU,, pranë Shoqatës për kulturë, arsim dhe art „KÖPRU,,
- redaktor për letërsi turke në shtëpinë botuese Logos- A në Shkup.

- nga nëntori 2011 –profesor i angazhuar për gjuhë osmane në Fakultetin Filozofik, Universitetin e Tetovës.
- Nga viti 2012- docent titullar në Institutin e Historisë Nacionale, Universiteti “ Shën Kirili dhe Metodi” Shkup

## 2. Veprimtaria shkencore

Nga biografia e paraqitur mund të shihet se Dr. Sulejman Baki pas përfundimit të studimeve të magjistraturës dhe të doktoraturës ka zhvilluar në veprimtari serioze shkencore.

Në vitin 2005 ai e publikoi transkriptimin, përkatësisht e përcjelli në alfabet latin bashkëkohor turk librin për historinë e Shkupit nga prefekti i njohur Salih Asim e shkruar në gjuhën arabe në vitin 1932. Vepra është publikuar me titullin: *Salih Asim, Üsküp Tarihi ve Civarı*, sadeleştiren Süleyman Baki, İstanbul, Rumeli Türkleri Vakfi Yayınları, 2005. Në këtë mënyrë kjo vepër jashtëzakonisht e rëndësishme për historinë e Shkupit u bë e kapshme për një rreth shumë më të gjerë të lexuesve të cilët kishin mundësi të njihen me historinë e Shkupit osman, por edhe me jetën dhe veprën e njërit nga prefektët më të rëndësishëm të Shkupit në shekullin XX. Përkatësisht, në hyrjen e librit e shkruar nga Sulejman Baki, është dhënë biografia e autorit të librit, Salih Asim, i cili ishte anëtar i Vilajetit të Kosovës, ndërsa duke filluar nga 1893 për 12 vite ishte në krye të komunës së Shkupit. Në këtë mënyrë Sulejman Baki para opinionit i paraqiti të dhënat dhe biografinë e njeriut i cili mund të konsiderohet themelues i Shkupit të sotëm. Në fakt, në kohën e këtij prefekti ishte mbuluar rrjedha e lumit Serava që kalonte nëpër Bit Pazar me çka u pamundësua përhapja e infektiveve përmes ujit të papastër, pastaj e rregulloi rrjedhën e lumit Vardar në qendër të Shkupit, duke i vënë themelet e bregut bashkëkohor dhe duke e ofruar bregun e Vardarit si vend për shëtitje të shkupjanëve, ndërsa kozmopolitizmi i tij dhe respekti ndaj të gjithë qytetarëve të Shkupit shihet në atë se ai e mundësoi restaurimin e kishës së sotme Shën Dimitri. Përmes transkriptimit të këtij punimi Sulejman Baki na e paraqet një personalitet jashtëzakonisht interesant, vlerat morale dhe njerëzore si dhe kualitetet e tij paraqesin edhe sot shembull për bashkimin kozmopolit të Shkupit.

Në vitin 2006 ai e botoi tezën e tij të magjistraturës me titull “*Manastırlı İsmail Hakkı, Kelami Görüşleri ve Telhisu’l-Kelam Eseri*”. Në këtë punim përpunohet tema për jetën dhe veprën e njërit nga njerëzit më të arsimuar që dolën nga Manastiri osman në shekullin XIX, Ismail Haki. Në këtë punim Sulejman Baki përmes studimit dhe analizës së veprës së Ismail

Haki, në njohës i dalluar i Islamit, e tregon kontinuitetin e shkencës së besimit në fushën e shkencës së përgjithshme osmane e cila zgjati në kuadër të Perandorisë Osmane deri te zhdukja politike në fillim të shek. XX.

Studimi i historisë së shkencës osmane është njëra nga segmentet më pak të përfaqësuara në hulumtimet e civilizimit të pasur dhe jetëgjatë osman, prej këtu ky punim i Sulejman Baki paraqet kontribut të rëndësishëm në mozaikun e quajtur histori e mendimit shkencor dhe fetar.

Gjithashtu punim mjaft i rëndësishëm i Sulejman Baki është edhe disertacioni i tij i doktoraturës: *“Formimi i klasës feudale në Gadishullin Ballkanik: Isa Beu nga Shkupi dhe familja e tij”*. Në këtë disertacion të doktoraturës përpunohet në temë jashtëzakonisht e rëndësishme nga historia osmane e gjithë Gadishullit Ballkanik, e kjo është formimi i aristokracisë feudale osmane në këto hapësira. Si shembull është marrë familja e Pashait Jigit Beu, pushtuesit të Shkupit. Kjo familje e cila më vonë do të bëhet e njohur si familja Kumbarxhi edhe sot është njëra nga familjet turke më të respektuara dhe më të vjetra të Shkupit. Në punimin e tij Sulejman Baki konstaton se Pasha Jigit Beu erdhi në Gadishullin Ballkanik së bashku me ekspeditat e para të Sulltan Muratit (1359-1389) dhe së bashku me familjen e tij ishte njëra ndër hallkat më të rëndësishme dhe baza më e fuqishme e Sulltanit për mbajtjen parësore të Osmanlinjve në territorin e Evropës. Familja e tij në ato vite të para por të rëndësishme për ardhmërinë Evropiane të Osmanlinjve, asnjëherë nuk e solli në pikëpyetje lojalitetin ndaj dinastisë osmane. Pasha Jigit Beu dhe pasardhësit e tij morën pjesë pothuajse në të gjitha betejat e rëndësishme që sulltanët e osmanlinjve i zhvilluan në territorin e Ballkanit në gjysmën e dytë të shek. XIV dhe gjysmën parë të shek. XV. Kjo është periudha kur osmanlinjtë definitivisht kishin sukses të etablohen në territorin evropian, duke mbetur fuqi dominante në shekujt e ardhshëm.

Duke e shfrytëzuar këtë qasje për studim dhe analizë të zgjerimit të pushtetit Osman në Evropë përmes familjeve të fuqishme, Dr. Baki e thekson tezën bazë të këtij disertacioni, e kjo është çështja e lojalitetit të këtyre feudalëve të mëdhenj ndaj Sulltanit dhe pushtetit të tij. Në fakt, ata në zenitin e pushtimeve të tyre posedonin fuqi të madhe ushtarake, ndodheshin larg nga qendra e pushtetit në mjedise krishtere, ndërsa territori që pushtojë ishte nën kontrollin e tyre absolut. Ata mundeshin shumë lehtë të shpallehin sundimtar të pavarur të një territori të caktuar. Për më tepër ata vepronin në kohën e integritetit në shtetin osman që kishte ndodhur pas betejës së Ankarasë (1402), kur ishte marrë peng e më vonë edhe ishte vrarë Sulltan Bajazidi dhe kur në shtet kishte shpërthyer luftë qytetare. Në atë periudhë pa pushtet dhe të luftërave vëllazërore për

fronin osman, ishte shumë lehtë të shpallej pavarësi nga dinastia e cila gjendej para kolapsit. Megjithatë ajo nuk kishte ndodhur. Pikërisht këtu Dr. Baki e parashtron çështjen kryesore, se a ishte me të vërtetë i pamposhtur ky lojalitet i këtyre feudalëve të mëdhenj dhe ata ishin fuqishëm ishin dhënë pas besimit ndaj Sulltanit? Ose nga ana tjetër, se dinastia osmane në atë kohë vetëm se e pat ngritur nivelin ideologjik të përjetohet si faktor i vetëm integrimi të fiseve turke pa të cilën ishte e paimagjinueshme ekzistenca e krijesës shtetërore të Turqve për çka ishin të vetëdijshëm edhe njerëzit më të fuqishëm rreth të Sulltanit. Ngjarjet e mëtutjeshme nga historia osmane treguan se pikërisht lojaliteti i këtyre feudalëve ndaj dinastisë osmane mbeti në skenën historike. Pikërisht këtu qëndron edhe kualiteti i këtij disertacioni të doktoraturës, përkatësisht në hapjen e hipotezave të reja dhe vendosje në pikëpyetje të tezave tashmë të vërtetuara nga hulumtues të mëparshëm.

Nga ky disertacion i doktoraturës Dr. Sulejman Baki nxori edhe disa momente të rëndësishme për historinë e Gadishullit Ballkanik, sikur që është roli i njërit nga anëtarët e kësaj familje, Gazi Isa Beut, në përhapjen e Islamit në Ballkan. Ai me punimin “Balkanların İslamlaşması’nda Gazi İsa Bey ve Ailesi” mori pjesë në simpoziumin „Balkanlarda İslam“ që u mbajt në Ankara më 24 qershor 2016. Ai referat e tregon edhe interesin e gjerë të Sulejman Baki për temat e ndryshme sikur që është procesi i islamizimit, njëri nga proceset më interesante dhe më të gjata në Historinë e Ballkanit në periudhën e dominimit osman.

Në veprimtarinë e tij shkencore Sulejman Baki, gjithashtu, mori pjesë edhe në dhjetëra konferenca vendore dhe ndërkombëtare dhe simpoziume në të cilat prezantoi tekste ku trajtohen tema nga më të ndryshmet dhe çështje të lidhura me historinë e Gadishullit Ballkanik në periudhën osmane.

Përveç me veprimtarinë shkencore, Dr. Sulejman Baki ka kontribut edhe në veprimtarinë pedagogjike dhe arsimore. Ai nga viti 2011 është i angazhuar si mësimdhënës i Gjuhës Osmane në Fakultetin Filozofik, të Universitetit të Tetovës, përkatësisht në programin studimor Filologji orientale, dhe gjithashtu nga viti 2014 edhe ligjërues në ciklin e dytë, lënda Paleografia dhe diplomacia osmane. Poashtu, nga viti 2012 është zgjedhur në thirrjen titullare docent në Institutin e Historisë nacionale në Universitetin “ Shën virili dhe Metodi” në Shkup. Në këtë mënyrë ai merr pjesë në formimit e kuadrit si cili e din gjuhën turke-osmane, aq i nevojshëm për studimin e dokumentacionit osman i cili ka të bëjë me historinë e Gadishullit Ballkanik.

## **Mendim me propozim**

Në veprimtarinë e përgjithshme të deritashme shkencore dhe arsimore të **Doc.dr. Sulejman Baki** tregon se ka në vazhdimësi përparim dhe një qasje jashtëzakonisht serioze shkencore . Punimet e tij trajtojnë procese të rëndësishme dhe interesante, ngjarje dhe personalitete nga e kaluara Osmane në Maqedoni dhe më gjerë dhe për këtë paraqet kontribut në shkencën e linguistikës dhe të historisë. Gjuha dhe stili i tij i shkrimit është i qartë dhe me qëllim konkret që autori dëshiron ta arrij. Me këtë rast ai shërbehet me metodologji shkencore të përshtatshme për disipinën shkencore që e studion, duke mos hequr dorë nga morali dhe etika shkencore që është e domosdoshme për një studim objektiv dhe të paanshëm të së kaluarës sonë të lidhur me Periudhën Osmane.

Në bazë të pasqyrës të prezantuar më lart si dhe nga të dhënat në **Shtojcë**, komisioni Recensues i vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtaritë mësimore-arsimore, shkencore-hulumtuese, profesionale-aplikative dhe ato me interes të gjerë dhe konstaton se kandidati **Doc.dr.Sulejman Baki** në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës (Buletini i universitetit), ka tubuar pikë të mjaftueshme duke e kaluar numrin minimal të pikëve që duhet të realizohen për zgjedhjen në thirrjen mësimore-shkencore **Profesor inrodinar**.

Duke pasur parasysh këtë që e thamë më lartë dhe kontributin e përgjithshëm shkencor dhe arsimor të **Doc.dr. Sulejman Baki**, Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filozofik dhe Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës me kënaqësi i propozojmë që **Doc.dr.Sulejmani Baki** të zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore **Profesor inordinar** për lëndët: **Gjuhë osmane I dhe II, Analiza e teksteve në gjuhën osmane dhe Historia e Perandorisë Osmane**.

**Tetovë, 25.11.2018**

**Komisioni recensues:**

**Prof.dr. Abdulla Hamiti (Kryetar)**

**Prof.dr. Ismail Ahmedi (Anëtar)**

**Prof.dr. Dragi Georgiev (Anëtar)**

## SHTOJCË

### PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE, SHKENCORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE

**Kandidati:** Sulejman Baki

**Institucioni:** Fakulteti Filozofik – UT, Tetovë

**Lëmia shkencore:** Filologji orientale

#### VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Nr.	Emri i aktivitetit:	Pikët
<b>1.</b>	<b>Mbajtja e ligjëratave (lëndët në ciklin e pare të studimeve)</b>	<b>90,6pikë</b>
1.1.	Gjuhë osmaneI, Filologji orientale, 2+2	4x15x6x0.04=14.4
1.2.	Gjuhë osmane I I, Filologji orientale, 2+2	4x15x6x0.04=14.4
1.3.	Analiza e teksteve në gjuhë osmane, Filologji orientale, 2+1	4x15x6x0.04=14.4
1.4.	Letërsia klasike turke, Filologji orientale, 2+1	1x15x3x0.04=1.8
1.5.	Letërsia e sufizmit, Filologji orientale, 2+1	1x15x3x0.04=1.8
1.6.	Gjuhë osmaneI , Filologji orientale-Shkup, 2+2	4x15x5x0.04=12
1.7.	Gjuhë osmane I I, Filologji orientale-Shkup, 2+2	4x15x5x0.04=12
1.8.	Analiza e teksteve në gjuhë osmane, Filologji orientale-Shkup, 2+1	4x15x6x0.04=14.4
1.9.	Të folmet turke në Ballkan, Filologji orientale, 2+1	3x15x1x0.04=1.8
1.10.	Letërsi turke në Ballkan, Filologji orientale, 2+1	3x15x2x0.04=3.6
<b>2.</b>	<b>Mbajtja e ligjëratave (lëndët në ciklin e dytë të studimeve)</b>	<b>12 pikë</b>
2.1	Paleografia dhe diplomacia osmane, Filologji orientale, 2+1	4x15x3x0.05=9
2.2	Letërsi klasike (e Divanit) dhe bashkëkohore turke, Filologji orientale, 2+1	4x15x1x0.05=3
<b>2</b>	<b>Konsultime me studentë</b>	<b>2.49 pikë</b>
2.1.	Gjuhë osmaneI, Filologji orientale, 2+2	20x6x0.002=0.24
2.2	Gjuhë osmane I I, Filologji orientale , 2+2	20x6x0.002=0.24
2.3	Analiza e teksteve në gjuhë osmane, Filologji orientale , 2+1	20x6x0.002=0.24
2.4	Letërsia klasike turke, Filologji orientale , 2+1	20x4x0.002=0.16
2.5	Letërsia e sufizmit, Filologji orientale , 2+1	20x3x0.002=0.12
2.6	Gjuhë osmaneI , Filologji orientale-Shkup, 2+2	20x6x0.002=0.24
2.7	Gjuhë osmane I I, Filologji orientale-Shkup, 2+2	40x6x0.002=0.48
2.8	Analiza e teksteve në gjuhë osmane , Filologji orientale-Shkup, 2+1	40x6x0.002=0.49
2.9	Tëfolmet turke në Ballkan, Filologji orientale, 2+1	15x1x0.002=0.03
2.10	Letërsi turke në Ballkan, Filologji orientale, 2+1	15x2x0.002=0.06
2.11	Paleografia dhe diplomacia osmane, Filologji orientale, 2+1	20x4x0.002=0.16
2.12	Letërsi klasike (e Divanit) dhe bashkëkohore turke, Filologji orientale, 2+1	15x1x0.002=0.03
<b>3.</b>	<b>Mentor i punimeve të diplomës</b>	<b>3.8 pikë</b>
3.1	Mentor i punimit të diplomës, vendimi nr. 02-689/1, data : 30.01.2014	0.2

3.2	Mentor i punimit të diplomës, vendimi nr16-1368/2, data : 08.06.2015	0.2
3.3	Mentor i punimit të diplomës, vendimi nr. 16-699/1, data : 29.04.2015	0.2
3.4	Mentor i punimit të diplomës, vendimi nr. 16-1016-2, data : 09.06.2016	0.2
3.5	Mentor i punimit të diplomës, vendimi nr.16-275/2, data : 19.02.2016	0.2
3.6	Mentor i punimit të diplomës, vendimi nr. 15-1446/2,data : 27.06.2014	0.2
3.7	Mentor i punimit të diplomës, vendimi nr. 16-2306/2, data : 29.12.2015	0.2
3.8	Mentor i punimit të diplomës, vendimi nr. 15-6570/2, data : 21.11.2014	0.2
3.9	Mentor i punimit të diplomës, vendimi nr. 15-4354/2, data : 09.07.2014	0.2
3.10	Mentor i punimit të diplomës, vendimi nr. 15-3598/2, data : 09.07.2014	0.2
3.11	Mentor i punimit të diplomës, vendimi nr.16-610/2, data: 30.05.2018	0.2
3.12	Mentor i punimit të diplomës, vendimi nr.16-1012/2, data: 30.06.2017	0.2
3.13	Mentor i punimit të diplomës, vendimi nr.16-1013/2, data:30.06.2017	0.2
3.14	Mentor i punimit të diplomës, vendimi nr.16-1082/2, data: 07.07.2017	0.2
3.15	Mentor i punimit të diplomës, vendimi nr.16-597/2, data: 25.05.2018	0.2
3.16	Mentor i punimit të diplomës, vendimi nr.10-1035/2, data:07.07.2017	0.2
3.17	Mentor i punimit të diplomës, vendimi nr.16-611/2, data:2018	0.2
3.18	Mentor i punimit të diplomës, vendimi nr.16-300/2, data:2018	0.2
3.19	Mentor i punimit të diplomës, vendimi nr.16-618/2, data: 05.06.2018	0.2
3.20	Mentor i punimit të diplomës, vendimi nr.16-609/2, data:2018	0.2
3.21	Mentor i punimit të diplomës, vendimi nr.16-549/2, data:30.03.2017	0.2
3.22	Mentor i punimit të diplomës, vendimi nr.16-548/2, data:30.03.2017	0.2
